



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 18 prot.

Kamëz më 15.02.2023

VENDIM

Nr. 12, datë 15.02.2023

PËR

**“NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.02 DATË 23.01.2023 MBI MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 15.02.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.12 Datë 14.02.2023 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr.141 datë 25.11.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Manualit për programin e subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, VKB nr 163 dt.21.12.2022 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2023, 2024, 2025”, shkresës me nr. Prot.13 dt. 04.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.383 Prot datë 16.01.2023 dhe me nr.1397 Prot datë 13.02.2023; Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.383/1 Prot datë 16.01.2023, dhe me nr.1397/1 Prot datë 13.02.2023 i propozojmë Këshillit Bashkiak Kamëz,

VENDOSI:

1. Trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës në Tabelën A dhe Tabelën B bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023 për

listën e familjeve në Tabelën A dhe për një periudhë dhjetë mujore duke filluar nga data 01.03.2023 deri në datën 31.12.2023, për listën e familjeve në Tabelën B .

3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 70% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 30% nga buxheti i Bashkisë Kamëz për listën e familjeve në Tabelën A , dhe në raportin 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz për listën e familjeve në Tabelën B.*

4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

